



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 1270/2024
Datë: 12 dhjetor 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 23 paragrafët 2 dhe 3 të Rregullores Nr.07/2024 për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 12 dhjetor 2024, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Znj. Bedrije Sylja Alshiqi, prokurore në Prokurorinë e Apelit, caktohet ushtruese e detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit.
2. Znj. Alshiqi, do të ushtrojë këtë funksion nga data 15 dhjetor 2024, deri në emërimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit.
3. Ushtruesja e detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit, znj. Bedrije Sylja Alshiqi, është e obliguar të ushtroj kompetencat dhe përgjegjësitë e saj në pajtim me legjislacionin në fuqi.
4. Znj. Alshiqi ka të drejtë në benificionet që dalin nga ushtrimi i funksionit të ushtrueses së detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit.
5. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Znj. Bedrije Sylja Alshiqi;
- Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit;
- Sekretariatit dhe Dosjes së prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.